

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



**PUNIMI I DIPLOMES – MASTER**

**DALLIMET NË DISA PARAMETRA TRUPOR  
NDËRMJET MESHKUJVE DHE FEMRAVE NË LOJËN  
E HENDBOLLIT**

**Mentori:**  
**Prof. Ass. Afrim Koca**

**Kandidatët:**  
**Kushtrim Berisha**  
**Granit Gashi**

**Prishtinë, 2016**

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>2. PROBLEMI, LËMIA, QËLLIMI I PUNIMIT.....</b>	<b>15</b>
<b>3. HIPOTEZAT THEMELORE .....</b>	<b>16</b>
<b>4. METODAT E HULUMTIMIT .....</b>	<b>17</b>
4.1 POPULLATA DHE MOSTRA.....	17
4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	18
4.3 TEKNIKA E MATJES .....	19
4.4 METODAT E PËRPINIMIT TË REZULTATEVE.....	30
<b>5. REZULTATET DHE DISKUTIMI .....</b>	<b>31</b>
5.1 PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË PËRBËRËSVE TRUPOR.....	31
5.2 MATRICA E INTERKORELACIONIT NDËRMJET NDRYSHOREVE TË PËRBËRËSVE TRUPOR TE HENDBOLLISTET DHE HENDBOLLISTËT.....	44
5.3 ANALIZA DISKRIMINATIVE E NDRYSHOREVE TË PËRBËRËSVE TRUPOR TE HENDBOLLISTET DHE HENDBOLLISTËT.....	49
5.4 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....	51
<b>6. PËRFUNDIMI .....</b>	<b>52</b>
<b>7. LITERATURA .....</b>	<b>54</b>
<b>REZYME .....</b>	<b>56</b>
<b>SUMMARY.....</b>	<b>57</b>

## 1. HYRJJE

Nga aktivitetet polistrukturale komplekse hendbollit, përpos që është ndër sportet shumë të popullarizuara dhe atraktive për të gjitha moshat, njëherit në shumë shtete është edhe ndër sportet fitim prurëse në aspektin material. Ky është edhe një motiv shtesë, që të rinjët në numër sa më të madh të kërkojnë të kyqen nëpër shkolla apo klube të hendbollit.

Përpos aspektit material që është ndër faktorët e rëndësishëm për rritjen e interesimit të të rinjëve për lojën e hendbollit, janë edhe aspektet tjera që ndikojnë në dëshirën e të rinjëve për të luajtur hendboll. Lojës së hendbollit mund ti përshtaten nerzit e të gjitha gjeneratatve për qëllime të ndryshme si ato shëndetësore, rekreative, garuese, e tj., pa marr parasysh zhvillimit të tyre morfologjik, aftësive të tyre motorike, aftësive funksionale apo mundësisë së përshtatjes së njerëzve në shoqëri.

Periudha e rritjes dhe zhvillimit të organizmit të adoleshentët është periudha më e ndjeshme ndaj ndikimit të aktiviteteve të ndryshme fizike që shkaktojnë ndryshime të shumfishta në karakteristikat morfologjike dhe në përmirësimin e aftësive motorike dhe funksionale. Pikërisht, kjo është arsyeja pse komponent e përbërjes antropologjike duhet të jenë përher në harmoni me kërkesat e lojës së sportit konkret (De Vris, 1976).

Aktiviteti fizik komplekse ku bënë pjesë edhe loja e hendbollit si një fenomen social ndikon pozitivisht në zhvillimin aftësive dhe veçorive antropologjike të njeriut. Përmbajtja, lloji i ushtrimeve si dhe intenziteti dhe ekstenziteti i ekzekutimit ndikojnë në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit, e sidomos në mbajtjen e peshës ideale e që do të thotë një raport në mes masës yndyrore dhe asaj jo yndyrore.

Duke pasur parasysh se në shekullin e 21-të gjithë e ma tepër potencohet rëndësia e lojrave sportive, si një element thelbësor për shëndetin e përonave që merren me këto lloje të sporteve, qofshin ato për qëllime sportive apo rekreative. Në rend të parë, aktivitetet sportive ndikojnë në parandalimin dhe reduktimin e mbipeshës, sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore si dhe shumë sëmundjeve tjera e që bënë të mendojmë dhe vepromë që aktiviteti sportiv të integrohet në jetën e përditshme si një nevojë

natyrore dhe e domosdoshme për të gjithë njerëzit. Aktiviteti fizik ka një efekt të fortë pozitiv në shëndetin e njeriut, sidomos në patogjenezën e sëmundjeve që përbëjnë sindromin metabolik (rezistenca e insulinës, diabeti tip 2, hyperlipidemia, hipertensioni, dhe mbipesha). Ka argumente të forta që flasin se aktiviteti fizik rrit kapacitetet funksionale dhe cilësinë e jetës (Vuori, I. 2004).

Mjedisi social të tilla si klubet sportive, shkollat, vendi i punës, familja dhe shokët, mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në nivelin e aktivitetit fizik sportiv. Duke e kuptuar mundësinë e rrethit dhe pengesat me të cilat përballemi në përpjekje të një jetese më të shëndetshme mund të sigurojmë njohuri të caktuara të nevojshme për përmirësimin e jetesës së shëndetshme.

Ka disa arsye që shkaktojnë mbipeshën. Një ndër to mund të jetë për shkak të çrregullimeve të caktuara hormonale apo çrregullimeve metabolike (Holford, 1999). Megjithatë, para së gjithash, mbipesha ndodh si rezultat i mungesës së aktivitetit fizik dhe diete të parregullt (Guyton dhe Hall, 2008). Domethënë, nëse në organizëm rregullt merren më shumë kalori se mund të harxhojmë, kaloritë e tilla të marra nga ushqimi do të konvertohet në peshë të tepërt në formën e yndyrës së depozituar. Shumica e njerëzve, për ti u larguar mbipeshës, iu nënshtrohen një dietave raskapitëse (urisë), e cila në të shumtën e rasteve përcillet me pasoja të shumta shëndetësore.

Si pasojë e urisë është humbja e indeve të muskujve që ndihmojnë në harxhimin e yndyrës të tepërt. Mënyra shumë më e mirë që të arrihet deri te qëllimi i dëshiruar është aktiviteti i rregullt fizik sportiv. Me ushtrime harxhohen rezervat e energjisë të deponuara si yndyrë, dhe shmanget humbja proteinave të muskujve (Malcko dhe Rađo, 2004). Për këtë arsye, energjia fitohet nga yndyrnat në raport me karbohidratet. Te personat që merren me aktivitetete fizike rritet aftësia e shfrytëzimit të yndyrës si burim të energjisë dhe uljen e rrezikut të sëmundjeve të ndryshme të tilla si diabeti. Në mënyrë që të largimit apo harxhimit të dhjamtit të tepërt, (Sharkey and Gaskill 2008) sugjerojnë se duhet të kombinohen dy llojet e trajnimit, trajnimi aerob dhe anaerob. Në kohën e sotshme gjithë e më tepër po dëshmohet fakti se aktiviteti sportiv është ndër faktorët kryesor që ndikon në zvogëlimin e peshës trupore dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës. Prandaj për të përcaktuar masën trupore po përdoren aparatura moderne që japin

shënime më të sakta dhe të shpejta mbi gjendjen e masës trupore në mënyrë që të programohen aktivitetet fizike.

Yndyra nënlëkurore i takon rendit të atyre karakteristikave të njeriut në të cilën gjatë jetës mund të ndikohet. Çdo njeri këtë karakteristikë antropologjike mund dhe duhet të rregullojë me aktivitet sportiv ushqim. Rregullullimin e kësaj karakteristike nuk do ta zbatojmë vetëm me ushqim e sidomos me humbje të shpejt të peshës. Sepse, kurrë nuk bëhet fjala vetëm për reduktimin e obezitetit, por edhe për punë normal e të gjithë organizmit, e cila nuk mund të arrihet vetëm dietë (Findak me bp., 1996). Në profesionin tonë, përbërja e trupit shikohet zakonisht si një model dy-komponent, i cili përbëhet nga: a) masa joindyrore e trupit, dhe b) masa yndyrore e trupit. Kjo ndarje na lejon për të llogaritur peshën optimale (Mišigoj-Durand, M. 1995), e që na jep udhëzime për trajtime në të ardhshmen si me anë të aktiviteteve sportive ashtu edhe me diete.

Loja hendbollit kërkon një nivel të caktuar të disa karakteristikave antropologjike ashtu që hendbollistët të veprojnë me sukses në situata të ndryshme si gjatë stërvitjeve ashtu edhe gjatë lojës. Ashtu sikurse ekzistojnë specifikat e disa sporteve të cilat karakterizohen nga diversiteti i strukturës garuese të tyre, ashtu ekziston edhe nevoja e vazhdueshme e hulumtimit teorik dhe kontrollit praktik të këtyre specifikave.

Aftësitë fizike janë tipare të personalitetit që kontribuojnë në ndryshimet në performancën e ekzekutimit të aktiviteteve të caktuara me kusht që të ekzistojë përvoja dhe motivimi (Pajevic, 2003).

Suksesi i sportistit në aktivitetet fizike varet nga tre grupe faktorësh:

- nga ajo çka mund (i referohet aftësive),
- nga ajo çka din (duke iu referuar nivelit të trajnimit dhe të dijës) dhe
- nga ajo çka don (i referohet motivimit, interesit, vlerave) (Vujmilović, 2012)

Ndonjëherë ndikimi dhe kontributi i hendbollistëve në të njëjtën lojë është i ndryshëm, madje edhe disa herë më i madh ose më i vogël çka në masë të madhe mund ti referohet ndryshimeve në aftësitë apo karakteristikat e tyre antropologjike. Ato definoohen si mundësi potenciale të sportistit për të kryer një aktivitet fizik ose të kryejnë detyrave të caktuara (Pajevic, 2003, 58). Aftësitë e mundshme janë të njohura

si predispozitë, dhe të aktualizuara, si njohuri dhe aftësi për llojin e aktiviteteve të caktuara.

Për të parashikuar një arritje të veçantë të sportistit në lojën e hendbollit, është e rëndësishme të njohim faktorët që ndikojnë në zhvillimin e atyre aftësive dhe nivelin e atyre aftësive. Në grupin e parë përfshihen faktorët trashëgues. Dispozitat që janë të bazuara në strukturat e trashëguar apo gjenetike të sistemit nervor, paraqesin përcaktuesit potencial për zhvillimin e aftësive të caktuara. Përndryshe, mbretro mendimi që trashëgimia përcakton koeficientin e intelegjencës IQ prej mbi 80% (Metikoš, Prot, Holman, Pintar dhe Orebin, 1989). Ky përcaktim është i barabartë ose edhe më të madh te disa aftësi sensorik dhe psikomotorik, kështu që koeficienti i trashëgimis për koordinim, precizitet, drejtpeshim dhe forcë shpërthyes është rreth 80% dhe për shpejtësi motorike, e cila është aftësia pothuajse tërësisht trashëguese arrin deri në 95% (Metikoš, Prot, Holman, Pintar dhe Orebin, 1989; Malacko, 1986).

Një tjetër faktor që mundëson që potencialet në personalitetin e sportistit të zhvillohen është mjedisi në të cilin jeton sportisti. Këtu para se gjithash mendohet në ndikimin e mjedisit fizik, mjedisit shoqëror në një kuptim më të gjerë, mundësive ekonomike të shtetit, nivelit të arritur kulturor dhe të ngjajshme. Të gjithë këta faktorë mund të kategorizohen në psikologji dhe në ato që definojnë si ndikimi i mjedisit. Ky është ai mjedis që favorizon zhvillimin e dispozitave të caktuara (Popoviç, 1975).

Faktori i tretë i rëndësishëm është vetaktiviteti me të cilën nënkuptojmë që sportistët investojnë përpjekje për të zhvilluar aftësitë e tyre përmes punës, stërvitjeve dhe të mësuarit.

Duke pasur parasysh shpjegimin e dhënë në aspektin e gjenezës dhe faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e saj, aftësitë mund të përkufizohen si një sistem potencial dinamik për kryerjen e lëvizjeve të caktuara, të fituara përmes aktivitetit në bazë të dispozitave trashëguese dhe nën ndikimin e mjedisit (Pajevic, 2003, 59).

Me efekte të përgjithshme morfologjike dhe ndikimin e tyre në sporte të caktuara nënkuptojmë ndikimin në përbërjen e trupit të hendbollistët brenda së cilës nxjerren në pah marrëdhëniet e favorshme në mes masës muskulore dhe asaj yndyrore nënlëkurore,

dhe parandalimin e mbipeshës që në shumicën e sporteve është faktori pengues në realizimin e suksesit. Efektet fiziologjike janë të orientuara në stimulimin e funksionimit të sistemit kardiovaskulare dhe të frymëmarrjes dhe efektit e cilësisë së kockave - sistemin e muskujve e tjerë.

Deri më tani janë kryer studime të shumta me hendbollist të niveleve të ndryshme në lidhje me kualitetin dhe kuantitetin e tyre. Kështu, në mesin e hulumtimeve gjenden edhe ato qëllimi i së cilave ishte vërtetimi i karakteristikave morfologjike dhe raporti i tyre në përbërjen e trupit të hendbollistët (Matkoviç Mišigoj-Durakovic, Matkoviç, 1998.).

Njohja e strukturës së disa dimensioneve të statusit psikosomatik të sportistit, me këtë edhe zhvillimit të tij, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të suksesshme të procesit stërvitor. Duke iu falënderuar numrit të madh të hulumtimeve të cilat janë marrur me përcaktimin e strukturës të disa pjesëve të hapësirës antropometrike, në shkallën e sotme të zhvillimit të shkencës në kulture fizike, me siguri të madhe mund të flasim mbi ekzistimin veçorive të ndryshme.

Me karakteristika morfologjike të strukturës të statusit psikosomatik të njeriut nënkuptojmë sistem të caktuar të dimensioneve latente antropometrike pa marr parasysh atë se, a janë zhvilluar këto dimensione nën ndikimin e veçantë të rrethit të jashtëm (me stërvitje të caktuar) apo jo. Në pajtim me këtë, që të vërtetohen në mënyrë shkencore dimensionet latente të kësaj hapësirë, zgjidhja është mbështetur në aplikimin e analizës faktoriale dhe analizës regressive. Kështu janë izoluar faktorët antropometrik të cilat janë definuar si dimensione latente (nga seria e variablave manifeste), dhe të cilat janë përgjegjëse për kovariabilitetin e gjendjeve të ndryshme manifeste dhe reaksioneve në atë hapësirë. Para se gjithash, analiza faktoriale mundëson të hyjmë në esencë të strukturës morfologjike dhe dimensioneve të tjera të statusit psikosomatik të njeriut duke zbuluar dimensione latente, të cilat janë përgjegjëse për manifestimet e jashtme të dukurive konkrete.

Sipas hulumtimeve të gjertanishme janë identifikuar katër faktorët të cilët përcaktojnë strukturën morfologjike të njeriut dhe që kanë koeficient të caktuara të

lindshmërisë\*. Këta janë: faktori i dimensioneve longitudinale, faktori i volumit trupor, faktori i dimensioneve transferzale dhe faktori i indit dhjamor nën lëkuror.

Tek moshat e ndryshme dhe sipas gjinisë këta faktorë nganjëherë bashkohen dhe kështu formojnë dy faktor gjeneral: Në njërin anë, kompleksi skeletor (dimensionet longitudinale dhe transferzale të skeletit), dhe në anën tjetër, kompleksi i përgjithshëm i volumit (volumi i trupit dhe indit dhjamor nën lëkuror).

Mirëpo, ka raste kur në analizën faktoriale, tek disa gjenerata lajmërohet faktori i parë gjeneral i ndarë në dy faktor, ndërsa të tjerët, të bashkuar si një faktor gjeneral dhe anasjelltas. Ndër ta, gjithsesi, faktori i dimensioneve transferzale më së paku është diferencuar.

Hulumtimet më vëllimore të analizës faktoriale tek variablat antropometrike kanë rezultuar me izolimin e tre faktorëve parësor.

faktori i dimensioneve longitudinale

faktori i volumit trupor dhe

faktori i indit dhjamor nënlëkuror.

Faktori i dimensioneve transferzale edhe në këtë hulumtim është izoluar, por jo në atë solucion të pastër sikurse faktorët tjerë. Zhvillimi fizik mund të kuptohet si formim kompleks morfologjik dhe fiziologjik dhe lidhjes së saj të ndërsjella me faktorët e mesit biotik dhe social të njeriut<sup>1</sup>. Gjitha proceset të cilat e karakterizojnë zhvillimin fizik, janë të kushtëzuara në mënyrë korelative me veprimet e ndryshme të faktorëve endogjen dhe ekzogjen. Ndër faktorët endogjen, posaçërisht, vend të rëndësishëm zënë faktori gjenetik, respektivisht, dispozita ( prirja ), si dhe me të janë të lidhura faktorët – e racës, gjinisë,

---

\* Koeficienti i lindshmërisë paraqet madhësinë e variancës të çdo faktori, i cili nën ndikimin komponentëve gjenetike, apo ajo pjesë e variancës, e cila nuk mund të ndryshohet. Koeficienti i lindshmërisë për dimensionet skeletore është 0.98, volumin e trupit 0.90, dhe indin dhjamor 0.50



sistemit endokrin si dhe indet dhe organet ejaktorë. Në esence, dispozita, si faktor i zhvillimit, nënkupton se zhvillimi i ndonjë veçorie të organizmit është i kushtëzuar në baza trashëguese. Në bërthamën e qelizës, në kromozome gjenden gjenet si material bartës trashëgues. Nëpërmes tyre barten dispozita për zhvillim, respektivisht, faktorët specifik trashëgues, si bartës të dispozitës për zhvillimin e veçorive të caktuara, të cilët veprojnë si në mënyrë direkte në organe, respektivisht, inde të cilat rriten, njashtu edhe përmes sistemit neuro-endokrin, i cili e drejton funksionin e aktivitetit të zhvillimit të indeve dhe organeve.

Bartësit kryesor të veçorive trashëguese, gjenet, nën ndikimin edhe të faktorëve të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, përcaktojnë zhvillimin e disa veçorive. Nga kjo, në bazë të dispozitës së gjenotipit, respektivisht, veçorive potenciale të dispozitës, nën ndikimin edhe të faktorëve të tjerë, gjatë zhvillimit vjen deri tek shfaqja e shumë veçorive të sendërtuara, si manifestime të realizuara me anë të interakcionit të veçorive të dispozitës dhe faktorëve të jashtëm. Faktorët e dispozitës definoohen me anë të kodit gjenetik. Sipas rezultateve të hulumtimeve të gjertanishme, kodi gjenetik është definuar si strukturë e veçantë e molekulës së acidit dezoksiribonukleik (ADN)<sup>2</sup>. Struktura e kodit gjenetik në masë më të madhe është e përcaktuar me anë të faktorëve hereditarë, por është e mundshme, në bazë të teorisë së Devriesit, që variabiliteti i caktuar i kodit gjenetik është pasojë e mutacioneve të rastësishme, nga të cilat disa mund të jenë të mjaftueshme, e disa të pa mjaftueshme nga pikëpamja adaptuese. Nuk ka argumente të besueshme që kodi gjenetik i pasardhësit mundë të jetë i ndryshuar në funksion të karakteristikave morfologjike dhe funksionale të prindërve të kushtëzuara me ndryshime të faktorëve ekzogjene, siç pohon teoria neolamarkiste mbi formimin e faktorëve të dispozitës. Të lidhur me trashëgimin, raca dhe gjinia, si dhe indet dhe organet efektore, kanë pjesëmarrje të rëndësishme në procesin e zhvillimit fizik. Gjithashtu, gjandrrat endokrine kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin e individit. Gjatë fazës evolutive të jetës së njeriut, përpos veprimit të të gjitha gjandrrave endokrine në zhvillimin fizik, në disa periudha kohore të zhvillimit, ndikimi i disa gjandrrave është më i theksuar e disa të tjerave më pak.

Rëndësia e ndikimit të tyre veçanërisht vërehet në rastet kur ndonjë proces patologjik përfshin gjëndrën, dhe kështu shkakton shmangie të konsiderueshme dhe të rënda në zhvillimin e individit. Ndër faktorët ekzogjen, para se gjithash mund ti veçojmë kushtet ekonomiko-sociale, gjeografike, klimatike, stinët e vitit, si dhe aktivitetet trupore. Edhe pse ndikimi i këtyre faktorëve manifestohet gjatë gjithë jetës, ky ndikim veçanërisht është i shprehur në vitin e parë të jetës, në kohën e parapubertetit dhe pubertetit. Në organizmin e njeriut veprojnë shumë faktorë që kanë ndikim pozitiv dhe negativ në zhvillimin e gjithanshëm fizik dhe fiziologjik të njeriut.

Aktiviteti fizik si një fenomen social ndikon pozitivisht në zhvillimin aftësive dhe veçorive antropologjike të njeriut. Përmbajtja e aktivitetit fizik (lloji i ushtrimeve si dhe intenziteti dhe ekstenziteti i ekzekutimit) ndikojnë në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit të gjitha moshat, e sidomos te personat me gjendje më të mirë ekonomike dhe sociale.

Duke pasur parasysh se në shekullin e 21-të gjithë e më tepër potencohet rëndësia e aktivitetit fizik, si një element thelbësor për shëndetin e njeriut, në rend të parë në parandalimin dhe reduktimin e mbipeshës, sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore si dhe shumë sëmundjeve tjera, aktiviteti fizik duhet të integrohet në jetën e përditshme si një nevojë natyrore dhe të domosdoshme për të gjithë njerëzit. Aktiviteti fizik ka një efekt të fortë pozitiv në shëndetin e njeriut, sidomos në patogjenezën e sëmundjeve që përbëjnë sindromin metabolik (rezistenca e insulinës, diabeti tip 2, hyperlipidemia, hipertensioni, dhe mbipeshë). Ka argumente të forta që flasin se aktiviteti fizik rrit kapacitetet funksionale dhe cilësinë e jetës (Vuori, I. 2004).

Aktiviteti fizik komplekse ku bënë pjesë edhe loja e hendbollit si një fenomen social ndikon pozitivisht në zhvillimin aftësive dhe veçorive antropologjike të njeriut. Përmbajtja, lloji i ushtrimeve si dhe intenziteti dhe ekstenziteti i ekzekutimit ndikojnë në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit, e sidomos në mbajtjen e peshës ideale e që do të thotë një raport në mes masës yndyrore dhe asaj joyndyrore.

Duke pasur parasysh se në shekullin e 21-të gjithë e më tepër potencohet rëndësia e lojrave sportive, si një element thelbësor për shëndetin e personave që merren me këto

lloje të sporteve, qofshin ato për qëllime sportive apo rekreative. Në rend të parë, aktivitetet sportive ndikojnë në parandalimin dhe reduktimin e mbipeshës, sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore si dhe shumë sëmundjeve tjera e që bënë të mendojmë dhe veprojmë që aktiviteti sportiv të integrohet në jetën e përditshme si një nevojë natyrore dhe e domosdoshme për të gjithë njerëzit. Aktiviteti fizik ka një efekt të fortë pozitiv në shëndetin e njeriut, sidomos në patogjenezën e sëmundjeve që përbëjnë sindromin metabolik (rezistenca e insulinës, diabeti tip 2, hyperlipidemia, hipertensioni, dhe mbipesha). Ka argumente të forta që flasin se aktiviteti fizik rrit kapacitetet funksionale dhe cilësinë e jetës (Vuori, I. 2004).

Mjedisi social të tilla si klubet sportive, shkollat, vendi i punës, familja dhe shokët, mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në nivelin e aktivitetit fizik sportiv. Duke e kuptuar mundësinë e rrethit dhe pengesat me të cilat përballemi në përpjekje të një jetese më të shëndetshme mund të sigurojmë njohuri të caktuara të nevojshme për përmirësimin e jetesës së shëndetshme.

Ka disa arsye që shkaktojnë mbipeshën. Një ndër to mund të jetë për shkak të çrregullimeve të caktuara hormonale apo çrregullimeve metabolike (Holford, 1999). Megjithatë, para së gjithash, mbipesha ndodh si rezultat i mungesës së aktivitetit fizik dhe diete të parregullt (Guyton dhe Hall, 2008). Domethënë, nëse në organizëm rregullt merren më shumë kalori se mund të harxhojmë, kaloritë e tilla të marra nga ushqimi do të konvertohet në peshë të tepërt në formën e yndyrës së depozituar. Shumica e njerëzve, për ti u larguar mbipeshës, iu nënshtrohen një dietave rraskapitëse (urisë), e cila në të shumtën e rasteve përcillet me pasoja të shumta shëndetësore.

Si pasojë e urisë është humbja e indeve të muskujve që ndihmojnë në harxhimin e yndyrës të tepërt. Mënyra shumë më e mirë që të arrihet deri te qëllimi i dëshiruar është aktiviteti i rregullt fizik sportiv. Me ushtrime harxhohen rezervat e energjisë të deponuara si yndyrë, dhe shmanget humbja proteinave të muskujve (Malcko dhe Rađo, 2004). Për këtë arsye, energjia fitohet nga yndyrnat në raport me karbohidratet. Te personat që merren me aktivitetete fizike rritet aftësia e shfrytëzimit të yndyrës si burim të energjisë dhe uljen e rrezikut të sëmundjeve të ndryshme të tilla si diabeti. Në mënyrë që të largimit apo harxhimit të dhjamtit të tepërt, (Sharkey and Gaskill 2008) sugjerojnë se

duhet të kombinohen dy llojet e trajnimit, trajnimi aerob dhe anaerob. Në kohën e sotshme gjithë e më tepër po dëshmohet fakti se aktiviteti sportiv është ndër faktorët kryesor që ndikon në zvogëlimin e peshës trupore dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës. Prandaj për të përcaktuar masën trupore po përdoren aparatura moderne që japin shënime më të sakta dhe të shpejta mbi gjendjen e masës trupore në mënyrë që të programohen aktivitetet fizike.

Mjedisi sociale të tilla si shkolla, vendi i punës, familja dhe shokët, mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në nivelin e aktivitetit fizik të individit. Duke e kuptuar mundësinë e rrethit dhe pengesat me të cilat përballemi në përpjekje të një jetese më të shëndetshme mund të sigurojmë njohuri të caktuara të nevojshme për përmirësimin e jetesës së shëndetshme.

Ka disa arsye që shkaktojnë mbipeshën. Një ndër to mund të jetë për shkak të çrregullimeve të caktuara hormonale apo çrregullimeve metabolike (Holford, 1999). Megjithatë, para së gjithash, mbipesha ndodh si rezultat i mungesës së aktivitetit fizik dhe diete të parregullt (Guyton dhe Hall, 2008). Domethënë, nëse në organizëm rregullt merren më shumë kalori se mund të harxhojmë, kaloritë e tilla të marra nga ushqimi do të konvertohet në peshë të tepërt në formën e yndyrës së depozituar. Shumica e njerëzve, për ti u larguar mbipeshës, iu nënshtrohen një dietave rraskapitëse (urisë), e cila në të shumtën e rasteve përcillet me pasoja të shumta shëndetësore. Si pasojë e urisë është humbja e indeve të muskujve që ndihmojnë në harxhimin e yndyrës të tepërt.

Mënyra shumë më e mirë që të arrihet deri te qëllimi i dëshiruar është aktiviteti i rregullt fizik. Me ushtrime harxhohen rezervat e energjisë të deponuara si yndyrë, dhe shmanget humbja proteinave të muskujve (Malcko dhe Rađo, 2004). Për këtë arsye, energjia fitohet nga yndyrnat në raport me karbohidratet. Te personat që merren me aktivitetet fizike rritet aftësia e shfrytëzimit të yndyrës si burim të energjisë dhe uljen e rrezikut të sëmundjeve të ndryshme të tilla si diabeti. Në mënyrë që të largimit apo harxhimit të dhjamtit e tepërt, (Sharkey and Gaskill 2008) sugjerojnë se duhet të kombinohen dy llojet e trajnimit, trajnimi aerob dhe anaerob. Në kohën e sotshme gjithë e më tepër po dëshmohet fakti se aktiviteti fizik është ndër faktorët kryesor që ndikon në zvogëlimin e peshës trupore dhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës. Prandaj për të

përcaktuar masën trupore po përdoren aparatura moderne që japin shënime më të sakta dhe të shpejta mbi gjendjen e masës trupore në mënyrë që të programohen aktivitetet fizike.

Masa yndyrore nënëkurore i takon rendit të atyre karakteristikave morfologjike të njeriut në të cilat gjatë jetës mund të ndikohet më së tepërmi. Çdo njeri këto karakteristika mund dhe duhet të rregullojë vet me dietë dhe ushtrime ose aktivitete trupore. Rregullimine peshës nuk duhet ta bëjmë vetëm me ushqim e sidomos me dieta të ashpra duke humbur peshë të madhe brenda një kohe të shkurtër. Sepse, kurrë nuk bëhet fjalë vetëm për reduktimin e obezitetit, por edhe punë normal të gjithë organizmit, e cila nuk mund të arrihet vetëm dietë (Findak et al., 1996). Në profesionin tonë ose në sport, përbërja e trupit më së shpeshti shikohet si një model dy-komponentësh që përbëhet nga: a) masa trupore jo yndyrore, dhe b) masa trupore yndyrore. Kjo ndarje na lejon për të llogaritur peshën optimale (Mišigoj-Durand, M. (1995), e cila jep udhëzime në trajtimin e ardhshëm si me ushtrime trupore ashtu edhe qasje me dietë.

Yndyra nënëkurore i takon rendit të atyre karakteristikave të njeriut në të cilën gjatë jetës mund të ndikohet. Çdo njeri këtë karakteristikë antropologjike mund dhe duhet të rregullojë me aktivitet sportiv ushqim. Rregullimin e kësaj karakteristike nuk do ta zbatojmë vetëm me ushqim e sidomos me humbje të shpejt të peshës. Sepse, kurrë nuk bëhet fjala vetëm për reduktimin e obezitetit, por edhe për punë normal e të gjithë organizmit, e cila nuk mund të arrihet vetëm dietë (Findak me bp., 1996). Në profesionin tonë, përbërja e trupit shikohet zakonisht si një model dy-komponent, i cili përbëhet nga: a) masa jo yndyrore e trupit, dhe b) masa yndyrore e trupit.

Kjo ndarje na lejon për të llogaritur peshën optimale (Mišigoj-Durand, M. 1995), e që na jep udhëzime për trajtime në të ardhshmen si me anë të aktiviteteve sportive ashtu edhe me diete. Një nga metodat moderne për të përcaktuar përbërjen e trupit, metoda e rezistencë e plotë bioelektrike (MRBE), bazohet në supozimin se rryma elektrike me shpejtësi kalon nëpër inde të cilat në përbërjen e vet kanë sasi të madhe të ujit. Duke pasur parasysh se yndyra në përbërjen e vet më së paku ka ujë, rezistenca e trupit ndaj përqueshmërisë së rrymës do të jetë në përputhje me sasinë e yndyrës në trup. Prandaj rezistenca elektrike paraqet indeksin e përgjithshëm të yndyrës trupore, dhe

bazuar në formula të ndryshme llogaritet përqindja e masës trupore jo-yndyrë dhe e masës yndyrore.

Informacionet zyrtare të karakteristikave morfologjike të sportistëve sidomos te indit dhjamor nënlëkuror dhe përbërsit tjerë trupor përshkruhen me vlera numerike, e që nuk lejojnë llogaritjen e një peshe optimale trupore duke pasur parasysh sasinë e indit dhjamor trupor. Një nga metodat moderne për përcaktimin e përbërjes trupore, metoda e rezistencës bioelektrike (RBE), bazohet në supozimin se rryma elektrike ma shpejt kalon nëpër inde të cilat janë të përbërë nga sasia më e madhe e ujit. Ashtu që indi dhjamor në përbërjen e vet ka më pak ujë rezistenca e trupit që i bënë rrjedhës së energjisë do të jetë në përputhje me sasinë e yndyrës në trup. Prandaj, rezistenca elektrike përfaqëson indeksin totalit të yndyrës trupore, në bazë të formulave të ndryshme llogaritet përqindjen e masës trupore jo-yndyrore dhe në masës yndyrore.

## 2. PROBLEMI, LËMIA, QËLLIMI I PUNIMIT

Preokupimet kryesore i shumë hulumtuesve përqëndrohen në rritjen e njohurive mbi zhvillimin morfologjik dhe përbërësve trupore të sportistëve te sportet ekipore, veçanarisht në lojën e hendbollit. Sepse, nga një pasqyrë e tillë varet edhe niveli shëndetësor, dhe arritjes sportive.

**Problemi** i këtij hulumtimi paraqet analizimin i disa parametrave morfologjik, sidomos i përbërësve trupore te hendbollistët dhe hendbollistet. Problemi i cili trajtohet në këtë punim është i një rëndësie të veçantë, sepse nga rezultatet e fituara mund të vlerësojmë dhe të jepet një pasqyrë reale të zhvillimit fizik dhe përbërësve trupor të kësaj popullate si dhe të japim një pasqyrë sa më reale të ndikimit të faktorëve të ndryshëm morfologjik dhe përbërësve në suksesin në lojën e hendbollit

**Lëmia** e hulumtimit paraqet karakteristikat morfologjike dhe përbërësve trupor te sportistët e lojës së hendbollit te dy gjinitë.

**Qëllimi** i këtij punimi është të përcaktohet raporti i zhvillimit fizik dhe përbërësve trupor si dhe të përcaktohet dallimi në mes hendbollistëve dhe hendbollisteve në zhvillimin fizik dhe përbërjen trupore.

### 3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë, problemit dhenë përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

**H<sub>1</sub>** – Distribucioni i fituar i ndryshoreve morfologjike dhe i përbërësve trupor nuk do të ketë shmangie nga distribucioni normal.

**H<sub>2</sub>** – Rezultatet e ndryshoreve morfologjike dhe i përbërësve trupor kanë koeficiente të korrelacionit ndërmjet veti statistikisht të rëndësishëm.

**H<sub>3</sub>** – Do të fitohet dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet hendbollistëve dhe hendbollisteve në ndryshoret morfologjike dhe përbërësit trupor dhe se ky dallim do të jetë statistikisht i rëndësishëm në nivel  $p=0.05$ .



## 4. METODAT E HULUMTIMIT

### 4.1 POPULLATA DHE MOSTRA

Popullata nga e cila është nxjerrë mostra për hulumtim për këtë punim është definuar si popullat e lojtarëve dhe lojtareve të Supeligës së Kosovës në Hendboll. Në këtë hulumtim janë përfshirë 30 hendbollistë dhe 30 hendbolliste, gjithsej 60 lojtare të hendbollit të dy gjinive të Supeligës së Kosovës.

Për llogaritjen e parametrave të përbërësve trupor të fituara nga aparati matës “TANITA” është aplikuar variabla antropometrike lartësia e trupit (ALART) mosha dhe gjinia, ndërsa paramterat tjerë të përbërësve trupor janë fituar me aplikimin e aparatit për matjen e përbërësve trupore matësi i firmës “TANITA” modeli BC-601. Peshorja përdoret ashtu që së pari futën shënimet për të testuarin: lartësia trupore, mosha dhe gjinia. Të anketuarat në në skajet e brendshme të aparatit zbatuar ashtu që thembrat e këmbëve vendosen në pjesët e veçanta metalike të peshores.

Figura 1. Aparati “TANITA” modeli BC-601



## 4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE

Mostrën e ndryshoreve të përbërësve trupor nga aparati matës “TANITA” e kanë përbërë ndryshoret:

1. Moshë kalendrike – (AMOKA)
2. Lartësia e trupit (ALART)
3. Peshë trupore (APETR),
4. Përqindja e undyrnave (AIDHN),
5. Masa muskulore (AMAMU),
6. Masa ose dendësia kockore (ADEKO),
7. Indeksi i masës trupore (AIBMI),
8. Harxhimi i kalorive (AHKAT),
9. Vitaliteti i trupit (AVITR),
10. Sasia e ujit trupor (ASUTR)
11. Yndyra viscerale e brendshme (AYNVI)

### 4.3 TEKNIKA E MATJES

1. Lartësia e trupit – ALART është matë me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes e testuara është e zbathur në përgatitje sportive dhe qëndron në drejtqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në aso pozite që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. E testuara drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapse të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metali.

*Foto 1. Matja e lartësisë së trupit – ALART*



2. Pesha e trupit – APETR është matë me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. E testuara, zbathur dhe në përgatitje sportive vendoset në mesin e peshorës dhe qëndron në drejtqëndrim. Aparati tanita e tregon në mënyrë elektronike peshën trupore, të shprehur në gram.

*Foto 2. Matja e peshës së trupit – APETR*



### 3. Përqindja e yndyrnave trupore – APERY

Një nga metodat moderne për të përcaktuar përbërësit e trupit, metoda e rezistencë e plotë bioelektrike (MRBE), bazohet në supozimin se rryma elektrike me shpejtësi kalon nëpër inde të cilat në përbërjen e vet kanë sasi të madhe të ujit. Duke pasur parasyshë se yndyra në përbërjen e vet më së paku ka ujë, rezistenca e trupit ndaj përqeshmërisë së rrymës do të jetë në përputhje me sasinë e yndyrës në trup. Prandaj rezistenca elektrike paraqet indeksin e përgjithshëm të yndyrës trupore, dhe bazuar në formula të ndryshme llogaritet përqindja e masës trupore jo-yndyrë dhe e masës yndyrore.

*Foto 3. Përqindja e yndurnave v - APERY*



#### 4. Masa muskulore trupore – AMAMU

Ky funksion është një tregues i peshës së masës muskulore. Masa muskulore e cila tregohet në këtë aparat përfshinë muskujt skeletore, muskujt e butë ose të lëmuar (të tilla si muskuli i zemrës dhe muskujt për tretjen e ushqimit) dhe ujin që përmbajnë këto muskuj.

*Foto 4. Masa muskulore trupore - AMAMU*





## 5. Masa ose dendësia kockore – ADEKO

Ky funksion tregon sasinë e kockave (nivelin e mineraleve të kockave, kalciumin apo minerale të tjera) në trup.

*Foto 5. Masa e dendësisë kockore - AMAKO*



## 6. Indeks i masës trupore – AIBMI

Indeksi i masës trupore (Body Mass Index-BMI), është një metodë e llogaritjes së të ushqyerit. Indeks i masës trupore llogaritet shumë thjeshtë, dhe bazohet në bazë të të peshës së trupit dhe lartësisë së trupit.

Kjo llogaritet duke përdorur një formulë shumë të thjeshtë:

Pesha (kg)/lartësia (m<sup>2</sup>) = IMT ose BMI

***Foto 6. Indeks i masës trupore - AIBMI***





## 7. Harxhimi i kalorive trupore – AHKAT

Norma e metabolizmit basal (BMR) është niveli minimal i energjisë që kërkohet nga trupi kur në gjendje e pushimit për të funksionuar. Rreth 70% e kalorive që konsumohen çdo ditë përdoren për metabolizmin bazë. Përveç kësaj, energjia shtohet me aplikimin e aktiviteteve fizike.

Mënyra themelore e llogaritjes së metabolizmit bazal është ekuacioni standard që përdor peshën e trupit dhe mosha. Tanita ka kryer kërkime të gjera në raport me Normen e metabolizmit basal dhe përbërjen e trupit, dhe kështu ka dhënë më shumë vlera të sakta. Kjo metodë është metodë e vlefshme mjekësore si aplikues indirekt ose kalorimetër indirekt .

***Foto 7. Harxjimi i kalorive trupore - AHKAT***



## 8. Vitaliteti i trupit – AVITR

Ky funksion llogarit vitalitetin trupor dhe tregon moshen mesatare në lidhje me llojet e metabolizmit. Nëse moshë është më e lartë se vitet aktuale të hendbollistes, atëherë ky është një tregues që hendbollistja duhet për të përmirësuar normën e saj metabolike. Rritja e ushtrimeve do të ndërtojë membranë të shëndetshme muskulore e cila do të përmirësojë dhe moshën metabolike.

*Foto 8. Vitaliteti trupor - AVITR*



## 9. Sasia e ujit trupor – ASUTR

Leximi i përqindjes së ujit në trup duhet të jetë udhëzues dhe nuk duhet të shërbejë për të përcaktuar përqindjen absolute të rekomanduar të ujit në trup. Është e rëndësishme për të ndjekur ndryshimet në afat të gjatë në përqindjen e përgjithshme të ujit në trup dhe për të ruajtur një konstant, përqindje të shëndetshme të ujit në trup. Me aparatit tanita sasia e ujit përcaktohet në bazë të përshkrimit të rrymës elektrike në tërë trupin.

*Foto 9. Përqindja e ujit trupor - ASUTR*



## 10. Yndyra viscerale e brendshme – AYNVI

Ky segment tregon nivelin e yndyrës viscerale në trup.

Yndyra e organeve të brendshme është yndyrë në brendësi, zgavrën e barkut që rrethon organet vitale në pjesën e barkut. Tanita si monitor i përbërjes së trupit do të japë edhe shkallën e pretenduar të masës së organeve të brendshme nga 1 – 59.

*Foto 10. Yndyra viscerale - AYNVI*



## 11. Moshë kalendrike – AMOKA

Për llogaritjen e moshës kalendrike është marrë për bazë ekstrakti i lindjes që shënimet e fituara janë krahasuar me moshën e fituar (vitaliteti trupor).

*Foto 11. Moshë kalendrike – APETR*





## 4.4 METODAT E PËRPINIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor që të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

2. **Lakorja e distribucionit** ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („skjunis”), dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës së rezultateve të shpërndara (lartësia e distribucionit) përmes koeficientit të sheshtë ("kurtozis").

3. **Shpërndarja** dhe shmangia nga distribucioni normal është vërtetuar me anë të testit të Kolmogorovit dhe Smirnovit si dhe Shapiro-Wilkut.

4. **Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

5. **Për vërtetimin e ndryshimeve** ndërmjet ekipeve në rezultatet e masës yndyrore dhe asaj joyndyrore është aplikuar analiza discriminative e **T – testit**.

## 5. REZULTATET DHE DISKUTIMI

### 5.1 PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR TË PËRBËRËSVE TRUPOR TE HENDBOLLISTET DHE HENDBOLLISTËT

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të ndryshoreve të përbërësve trupor te hendbollistet e Supeligës së Kosovës në Hendboll. Në tabelë janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Gjithashtu është vërtetuar shmangia nga distribucioni normal e rezultateve me anë të testit të Kolmogorovit-Smirnovit dhe Shapiro-Wilkut. Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikoneve të paraqitura nën tabelën 1 dhe grafikonet 1a-11a.

*Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve të përbërësve trupor te hendbollistet*

	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.	KOSM.	SHAWI.
MOSHA	30	18.00	29.00	21.4000	3.68220	1.181	-.148	.000	.000
